

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: Aktivitetin e Prokurimit: Shërbime mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës-Pastrimi dhe Mirëmbajtja Hixhenike- Lot 2

Nr1 i prokurimit	101-25-4038-2-1-5
Nr i brendshëm	KU101 25 025 2-1-5

Sa i përket tenderit për: Aktivitetin e Prokurimit: Shërbime mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës-Pastrimi dhe Mirëmbajtja Hixhenike- Lot 2

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

UNI PROJECT shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Krasniqi, pn

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344160619

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Agim Bilalli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@uniproject.org

(Adresa elektronike)

09.06.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Ftesa për ofertë 13.05.2025
- Hapja e ofertave 16.05.2025
- Vendimi i AK-se dhe Letrat Standarde 23.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Jemi njoftuar përmes sistemi elektronik e-prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?.

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

- Kërkesa për rishqyrtim është bërë me datë 28.05.2025 përmes E-prokurimit
- AK-Kuvendi i Kosovës ka nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë 02.06.2025.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 26 Nënshkrimi i kontratave
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës
- Neni 60 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohor
- Neni 61 Përzullimi i aktivitetit të prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datë 23.05.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me Vendimin e AK-se dhe Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar.

Pretendimi ankimor 1

Sipas AK-Kuvendi i Kosovës oferta e jonë nuk ka plotësuar kërkesat e kapacitetit teknik dhe Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Nuk keni plotësuar kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional.

Gjatë fazës së vlerësimit të ofertës së OE UNI PROJECT SH.P.K., Autoritet Kontaktues, në pajtim me nenet 59-72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me përmbushjen e kriterëve për kapacitetin teknik dhe profesional, përfshirë pozitat kyçe të stafit të propozuar në ofertë.

Pozita: Menaxher i Projektit.

Keni propozuar për këtë pozitë z. Besnik Vrella, i diplomuar në programin Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës nga kolegji ESLG.

Megjithatë, diploma e paraqitur nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit, ku është kërkuar që kualifikimi të jetë në njërin nga fushat e mëposhtme:

- Administratë Publike;
- Menaxhment;
- Ekonomi;
- Drejtime Teknike.

Për të mbështetur përputhshmërinë e diplomës me kriterin e kërkuar, Ju keni dorëzuar një vërtetim zyrtarë të datës 09.04.2025, në të cilin thuhet se programi përkatës klasifikohet në fushën e studimeve të biznesit dhe shkencave menaxheriale, sipas kodifikimit ERASMUS.

Për të verifikuar këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues ka dërguar një kërkesë zyrtare për sqarim në adresë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), me pyetjet në vijim:

1. A ka qenë programi Master në Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës në kolegjin ESLG i akredituar nga AKA në kohën përkatëse të studimeve.
2. A bie ky program, sipas akreditimit të miratuar nga AKA, brenda fushës së Menaxhmentit ose të shkencave menaxheriale në puthje me klasifikimet dhe standardet e akreditimit

AK e ka informuar AKA-n se kjo çështje është urgjente, për shkak të karakterit emergjent të shërbimit të kërkuar. megjithatë, deri në momentin e hartimit të këtij raporti, nuk është pranuar ndonjë përgjigje zyrtare nga AKA, andaj dokumentet e dorëzuar nga OE nuk mund të konsiderohen si dëshmi të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së përcaktuar për këtë pozitë.

Duke qenë se dokumentacioni i ofruar nuk dëshmon në mënyrë të qartë përputhshmërinë e diplomës me fushat e kërkuara në Dosjen e Tenderit, dhe përderisa mungon një konfirmim zyrtar nga institucioni kompetent (AKA), AK konkludon se kriteri për kualifikimin e Menaxherit të Projektit nuk është përmbushur.

OE UNI Projekt sqaron se sipas përshkrimit te mësipërm rezulton se AK-Kuvendi Komunal i Kosovës ka bërë shkelje te rëndë te dispozitave ligjore te lartcekura ne procesin e vlerësimit te tenderëve. Është për keqardhje se si AK-Kuvendi i Kosovës përmes zyrës se prokurimi bënë shkelje te tilla ne procesin e vlerësimit ku edhe vet AK e pranon se nuk kemi marrë përgjigje nga AKA ne lidhje me pyetjen e dërguar në AKA. Pa mundësia e AK-se për te marrë një përgjigje ne AKA rezulton me eliminimin tonë pra një jo profesionalizëm i autoritetit kontraktues na faturohet neve si mos plotësim i kushteve te dosjes se tenderit.

Nga ky vlerësim dhe konstatim i autoritetit kontraktues duke bërë shkelje te rënda te LPP-së lind pyetja pse AK pasi nuk ka pranuar përgjigje nga AKA nuk e ka pranuar diplomën tonë si në harmoni me kërkesat e dosjes pasi qe nuk ka pranuar përgjigje. Me vet faktin se AK-Kuvendi i Kosovës ka kërkuar sqarime tek AKA rezulton se AK nuk ka mundur vet te vlerësoj ne lidhje me këtë pikë ndërsa në anën tjetër kur nuk merr përgjigje neve na eliminon përsëri. Nga kjo lind pyetja tjetër se si AK erdhi deri te një konkludim i tillë pa pranuar përgjigje nga AKA.

Andaj bazuar ne përshkrimin e mësipërm kërkojmë nga zyra e prokurimit e AK-Kuvendi i Kosovës dhe menaxhmenti i Kuvendit te Kosovës qe te ndërmarrin masat parandaluese te shkeljeve te tilla sepse është mundësia e fundit te behën korrigjimet e nevojshme duke kthyer lëndën ne rivlerësim.

Pretendimi ankimor 2

AK-Kuvendi i Kosovës përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar na ka dërguar këtë arsyetim:

Pozita: 5.4 Mirëmbajtës dhe manipulues me sistemet dhe pajisjet për ngrohje, aklimatizim dhe ventilim Lidhur me dokumentacionin e dorëzuar për Kërkesën nr. 5.4, që ka të bëjë me pozitën Mirëmbajtës dhe manipulues me sistemet dhe pajisjet për ngrohje, aklimatizim dhe ventilim, Ju keni paraqitur dokumentacion për të dëshmuar përvojën e punës në fushën përkatëse për punonjësin e propozuar, z. Shpëtim Mjeku.

Megjithatë, nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni vërehet mospërputhje ndërmjet të dhënave të paraqitura në CV dhe atyre të pasqyruara në referencat e punës, të cilat janë dorëzuar si dokumente mbështetëse.

Edhe tek ky pretendim ankimor AK-Kuvendi i Kosovës jep informata kontradiktore dhe në kundërshtim me njëra tjetrën qe bie edhe ne kundërshtim me vet arsyet e eliminimit te dërguar tek ne përmes letrës standarde.

Në njërën anë i referohet nenit 10.1 te Udhëzuesit për Prokurimin Publik, qe thotë: CV-ja përben dokumentin bazë mbi të cilin Autoriteti Kontraktues e bën vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për kapacitetin profesional.

Ndërsa brenda te njëjtit dokument (Letrës Standarde mbi tenderuesin e eliminuar) shkruan se të dhënat e paraqitura në CV nuk janë të mbështetura me dokumentacion të vlefshëm dhe në përputhje me periudhat dhe përshkrimet e deklaruara të punës. Nëse CV –se i referoheni si dokument bazë sipas nenit 10.1 te Udhëzuesit atëherë pse duhet te eliminohemi për te dhënat e paraqitura ne CV. Autoriteti Kontraktues nuk e dëshmon se cilat janë te dhënat qe nuk përputhen ne mes CV-se dhe dokumenteve tjera , pra nuk jep detajet e caktuar te mos përputhjes mirëpo vetëm na eliminon neve si OE i përgjegjshëm pa ndonjë arsyeje.

Pretendimi nr. 3.

Nga platforma ne E-prokurim konstatojmë se AK-Kuvendi i Kosovës me datë 26.05.2025 ka nënshkruar kontratën për këtë aktivitet të prokurimit pa pritur afatet e kërkesave për rishqyrtim dhe të ankesave dhe kështu ka bërë shkelje të neneve 26 të LPP-se , 108 A, 109 dhe neneve 61 dhe 62 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022.

AK-Kuvendi i Kosovës ka nënshkruar kontratën pa pritur afatet e ankesave dhe në kundërshtim të plotë me nenet e lartcekura. Kjo përben shkeljen e radhës nga AK-Kuvendi i Kosovës në këtë procedurë të prokurimit.

Në vijim paraqesim pretendimet ankimore ne raport me ofertën e operatorit ekonomik të shpallur fitues-nënshkrues i kontratës.

Pretendimi nr. 4

- Me datë 28.05.2025 prej orës 10:00 na u është mundësuar qasja në dokumentet zyrtare dhe pas kësaj kemi analizuar dokumentet si në vijim:

Pas analizës së dokumenteve të cilat i ka dorëzua OE EJONA, kemi konstatuar gjetjet si në vijim:

- Në DT kërkohet që Menaxheri i projektit duhet të ketë diplomë Bachelor ose Master në njërin nga lëmitë që ata i kanë ceke. Kërkesën për verifikim të diplomës së Masterit e kanë dorëzua në Agjencion të Akreditimit, kurse diplomën e Bachelorit nuk e kanë dorëzua fare për verifikim në RIT-AUK (Universiteti Amerikan). Vërehet që kanë pasë tendence.

Pretendimi nr. 5.

- Diplomat e 3 teknikeve nuk janë në përputhje me kërkesat në Dosje të Tenderit (shih dokumentet e bashkangjitura).

Në vitin 2022 vet Kuvendi i Kosovës na ka shpallë të papërgjegjshëm për shkak se një pjesë e stafit tone kanë pasë diploma të ngjashme që janë leshu nga IPVK (Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës). Të bashkangjitur e kemi Vendimin e AK-së të datës 08.04.2022.

Andaj nga kjo rezulton se AK-Kuvendi i Kosovës në procedurën e vlerësimit ka përdorë në vazhdimësi standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertës sonë edhe në të kaluarën.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, pas lejimit të çasjes në dokumente zyrtare me datë 28.05.2025 në si operator ekonomik ofertues i përgjegjshëm e kemi bindjen e plotë që oferta e jonë është trajtuar në kundërshtim të plotë me nenin 7, 59, 60, 72 të LPP-së sepse AK-Kuvendi i Kosovës nuk ka trajtuar ofertën tonë sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të merr:

VENDIM

TË APROVOHET ankesa si e bazuar

TË ANULOHET vendimi i AK-së i datës 23.05.2025 mbi dhënien e kontratës.

Të kthehet lënda në **RIVLERËSIM**, dhe ne si operator ekonomik i përgjegjshëm të shpërblehemi me kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përmes kthimit të lëndës në rivlerësim OSHP do të ndal praktiken e keqe të vlerësimit të aktiviteteve të prokurimit sa i përket aktiviteteve të prokurimit që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e objekteve të kuvendit të Kosovës për Lot 2. AK-Kuvendi i Kosovës me të njëjtat standarde të dyfishta të vlerësimit ka vepruar edhe në tenderin e parë i cili është në proces ankimor në OSHP.

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

2,000.00Euro përgatitja e dosjes dhe ankesave dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës”
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,
- e) Dëshmitë e sqarimeve shitesë
- f) Kërkesa për rishqyrtim
- g) Vendimi i AK-se mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*